

VENDIM
Nr. 159, datë 6.10.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETETEVE TË
SHOQËRISË “EURON ENERGY” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8, të rregullores “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.119, datë 21.7.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu, dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat: “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licencuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); “d” (përshkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar); “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen); “i” (deklarate me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehe gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me germën “j” të pikës 1 të nenit 7 (nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt), do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Euron Energy” sh.p.k., për lënie peng të asetëve në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti